



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.Sh. "Radio Zëri i Pozheranit"
Pronar – Shyqyri HALABAKU
RADIO ZËRI I POZHERANIT
Pozheran
Vitet

Ref:1905/626/LIC/ni

VENDIM

*për ndërprerjen e licencës të Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audio - Radio Zëri i Pozheranit,
me seli në Pozheran, komuna e Vitisë*

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuele, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio Zëri i Pozheranit është ofrues i shërbimit medial audio (radio) i licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetim tokësorë të programeve të radios, me seli në Pozheran, komuna e Vitisë. Radio Zëri i Pozheranit është pajisur nga KPM, me licencë afatgjatë të transmetimit me datën 6 tetor 2009 dhe e njëjta i është ripërtërirë në pajtim me nenin 25 të Ligjit të KPM-së edhe për shtatë (7) vite, që nënkupton se licenca e Radio Zëri i Pozheranit është e vlefshme deri më 6 tetor 2023.
3. Më datën 21 dhjetor 2018, pronari i Radio Zëri i Pozheranit, përmes e-mali, ka njoftuar KPM-në, se ky radio stacion nuk është duke transmetuar program dhe se për arsye financiare heq dorë nga licenca e KPM-së.

Arsyetimi


4. Pronari i Radio Zëri i Pozheranit ka njoftuar se, arsye për ndërprerjen e transmetimit dhe heqjen dore nga licenca e KPM-së janë vështirësitë financiar me të cila është duke u përballur ky radio stacion.

5. Duke marrë parasysh njoftimin e pronarit të Radio Zëri i Pozheranit, për heqje dorë nga licenca në mënyrë vullnetare, Komisioni konstaton se, ka bazë të mjaftueshme për ndërprerjen e licencës së Radio Zëri i Pozheranit.

VENDIM

6. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 17 qershor 2019, merr vendim për ndërprerjen e licencës së Radio Zëri i Pozheranit, sipas kërkesës për heqje dorë nga licenca në mënyrë vullnetare, ndërsa, obligimet financiare ndaj KPM-së të shlyhen në pajtim me legjislacionin në fuqi.

7. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.



Muja FERATI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



17.06. 2019

_____ datë